



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë më, \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË**  
**TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR (SPE)**

Për: **Shoqerine "GTS" Shpk, NIPT: J61905015B**  
Adresa: Vaqarr, Tiranë

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **"Furnizim me oksigjen te lëngshëm mjekësor për nevojat e QSUNT"**,  
Procedurë e Hapur (Mbi kufirin e lartë monetar) – Prokurim Elektronik – Mallra, MK me një OE me të gjitha kushtet e përcaktuara;

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-80448-11-27-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

**OBJEKTI:** "Furnizim me oksigjen te lëngshëm mjekësor për nevojat e QSUNT";

**FOND LIMIT:** Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër është **908'315'199** (nëntëqind e tetë milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH;

Çmimi për njësi për një litër O2 të lëngshëm mjekësor, është: 135.22 (njëqind e tridhjetë e pesë presje njëzet e dy) Lekë pa TVSH Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X**

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatore ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:**

- |  |   |   |
|--|---|---|
| 1. "LG West Balkan<br>NIPT: EDB4030003468470<br>Emri i plotë i shoqërisë | & | Filo Gas Shpk,<br>NIPT: L44217001H<br>numri i NIPT-it |
|--|---|---|

**Vlera: 838,992,518,6** (tetëqind e tridhjetë e tetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë presje gjashtë) **leke pa TVSH. Çmimi për njësi: 124,9** (njëqind e njëzet e katër presje nëntë) lekë pa TVSH;

2. “GTS” Shpk,  
Emri i plotë i shoqërisë

NIPT: J61905015B  
numri i NIPT-it

**Vlera: 908,248,025,94** (nëntëqind e tetë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e njëzet e pesë presje nëntëdhjetë e katër) **leke pa TVSH; Çmimi për njësi: 135,21** (njëqind e tridhjetë e pesë presje njëzet e një) lekë pa TVSH;

#### Operatorë Ekonomik të s’kualifikuar:

1. “LG West Balkan  
NIPT: EDB4030003468470  
Emri i plotë i shoqërisë

& Filo Gas Shpk,  
NIPT: L44217001H  
numri i NIPT-it

**Vlera: 838,992,518,6** (tetëqind e tridhjetë e tetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë presje gjashtë) **leke pa TVSH. Çmimi për njësi: 124,9** (njëqind e njëzet e katër presje nëntë) lekë pa TVSH;

**Arsyeja e skualifikimit:** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE konstaton se **oferta** nuk përmban të gjithë informacione të kërkuar në DST, referuar parashikime të LPP dhe VKM 914/2014, “*në veçanti Neni 74 Bashkimi i operatorëve ekonomikë, pika 3. Ku thuhet se: Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje*”. dhe gjithashtu, dokumentacioni i paraqitur nuk është në formën e kërkuar nga ligji, e konkretisht: Kriteret e veçanta për kualifikim Referuar kërkesave të përcaktuara në DST për paraqitjen e kriterëve të veçanta për kualifikim, është e përcaktuar se: *e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveçrastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë*). Në DST është përcaktuar se: “*Për operatorët ekonomik të huaj në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në DST për sa i përket Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, që kanë të bëjnë me dokumente ligjore që lëshohen nga institucione publike në RSH apo institucione ekuivalente ligjore me to nëpër vënde të tjera, nëse dokumentet e kërkuara ose ekuivalentet me to nuk ekzistojnë sipas dispozitave të ligjit vendas të tij, atëherë duhet të paraqesin vetë deklaratimet e tyre në përmbushje të kriterit të kërkuar. Në deklaratën e paraqitur duhet të deklarojnë institucionin që mbulon fushën e veprimtarisë për të cilën bëhet deklarimi si dhe duhet të bëjnë publik në deklaratë, linkun e ueb-it të institucionit që mbulon fushën e veprimtarisë, në rastin e verifikimit nga KVO*”. Sipas dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi “LG WEST BALKAN”, rezulton se mungon dokumenti që vërteton shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, apo vetë deklaratimin e tij në përmbushje të kriterit të kërkuar. Ky dokument nuk rezulton që të jetë dorëzuar në SPE. Në kriteret e veçanta për kualifikim, ku në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë, gërma b) është përcaktuar se: (b)

*”Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë Certifikaten ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit”.* Sipas dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi “FILO GAS” sh.p.k, rezulton se Çertifikaten ISO 9001:2015 mbi *“Sistemet e menaxhimit të cilësisë”* nuk rezulton që të jetë dorëzuar në SPE. Në kriteret e veçanta për kualifikim, ku në pikën 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar gërma a) është përcaktuar se: *”Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit (2017, 2018 dhe 2019) ku vlera mesatare e tyre te jete sa 40% e vlerës së fondit limit\* të procedurës për të cilën konkurron operatori”.* Sipas dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi “FILO GAS” sh.p.k, rezulton se në vërtetimin për xhiron e tre viteve të fundi Nr. T03491603, datë 30.01.2021, mesataria e tre viteve, duke mbledhur xhiron e tre viteve dhe duke e pjestuar me tre është në vlerën e 28,354,695 (njëzetë e etetë milion e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, ndërsa vlera e 20% (pjesë takuese) qe operatori ekonomik “FILO GAS” sh.p.k, duhet të plotësojë nga 40% i fondit limit (ndarje e bërë ndërmjet dy operatorëve në kontratën e bshkëpunimit të përkohshëm ku OE “LG WEST Balkan” ka 80 % dhe OE “FILO GAS” sh.p.k ka 20 %), i cili është 72,665,216 (shtatëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë. Sa më sipër kriteri për kapacitetin ekonomik dhe financiar nuk përmbushet nga OE “FILO GAS” sh.p.k. Në kriteret e veçanta për kualifikim, ku në pikën 2.3. Kapaciteti teknik gërma (a) është përcaktuar se: *Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40% e vlerës së Fondit Limit\* të procedurës për të cilën konkurron operatori dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi. Për kontratat e realizuara me institucione publike duhet të paraqesë kontrata/kontratat perkatese te shoqeruara me vërtetimin e realizimit me sukses te saj/te tyre. Për kontratat e realizuara me subjekte private duhet të paraqesë vetem faturat tatimore te shitjes, ku te shprehen qarte datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.* Sipas dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi “FILO GAS” sh.p.k, rezulton se ai nuk ka kontrata të ngjashme me institucione publike, kështu që ky OE ka dorëzuar në SPE fatura tatimore shitje me subjekte private të cilat janë të ndryshme, pra jo të përshtatshme me objektin e procedurës i cili është oksigjen mjekësorë i lëngshëm. Faturat e paraqitura nga OE “FILO GAS” sh.p.k, përmbajnë oksigjen të lëngshëm, oksigjen të gaztë, gaz azot, gaz hidrogjen, gaz argon, dioksid karboni etj. Në DST është përcaktuar se 40% i vlerës së fondit limit të procedurës për të cilën konkurron operatori dhe qe eshte realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi, KVO ka bërë të përlllogaritjen e vlerave të faturave, duke marrë të gjitha faturat e dorëzuara nga OE, konkretisht faturat e viteve 2017, 2018, 2019, 2020 (ku duheshin marrë vetëm të viteve 2018, 2019, 2020 sipas përcaktimit të pikës 2.3 gërma a). Mbledhja e tyre (e 4 viteve) rezultoi të ishte në vlerën 65,434,223 (gjashtëdhjetë e pesë milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e njëzetë e dy) lekë, vlerë e cila nuk e përmbush 20% (pjesë takuese) qe operatori ekonomik “FILO GAS” sh.p.k, duhet të plotësojë nga 40% i fondit limit, i cili është 72,665,216 (shtatëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë. Kapaciteti teknik i kërkuar në DST edhe pse KVO ka përlllogaritur faturat e katër viteve, ato përsëri nuk arrijnë vlerën e 20 % që duhet të plotësojë ky operator, gjithashtu këto fatura nuk janë në përputhje me objektin e

prokurimit, për rrjedhojë kapaciteti teknik nuk përmbushet nga OE “FILO GAS” sh.p.k. Në gërmën (b) dhe (c), të pikës 2.3, kapaciteti teknik, është përcaktuar se: b) *Për barnat e autorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet dokument lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore që bari i ofertuar është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë ose certifikatë regjistrimi e barit për tregtim në RSH, brenda afatit të vlefshmërisë. c) Për barnat e paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohet duhet: - të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi; /ose/ - të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm kur ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tyre, /ose/ - të jetë i pajisur me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Europiane e Vlerësimit të Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. **Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë: Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se Bari që ofron është i pajisur me autorizim tregtimi dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme ose që disponon autorizim tregtimi nga FDA ose EMA. Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë lëshuar autorizimin e tregtimit; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, ëb-site); numri dhe data e lëshimit të autorizimit të tregtimit të barit që ofron, (pranë këtij institucioni) dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi. Operatori ekonomik “FILO GAS” sh.p.k, në lidhje me këto kërkesa nuk ka paraqitur asnjë dokument i cili të vërtetojë se bari i ofertuar është i autorizuar për tregtim në RSH apo dokument i cili të vërtetojë sipas gërmës c, të pikës 2.3 kapaciteti teknik. Në lidhje me gërmën (ç) dhe (d), të pikës 2.3 kapaciteti teknik, është përcaktuar se: ç) **Kërkohet Autorizim: Në rastin e parashikuar në pikën “b” të kritereve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesiose distributori zyrtar i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja e këtij të fundit me MAH) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tyre. **Autorizimi duhet të jete i vlefshem per te gjithë periudhen e kerkuar.** Në rastin e parashikuar në pikën “c” të kritereve të kapacitetit teknik të DST, kërkohet Autorizim nga MAH (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit) ose nga prodhuesi ose distributori zyrtar i autorizuar (ku të provohet/dokumentohet lidhja mes këtij të fundit dhe MAH) nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barin objekt prokurimi. **Autorizimi duhet të jete i vlefshem per te gjithë periudhen e kerkuar.** d) **Deklarate e ofertuesit mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompaninë prodhuese / MAH) perbarine ofertuar.** Operatori ekonomik “FILO GAS” sh.p.k, në lidhje me kriteret teknike të përkujara në pikën 2.3, gërma (ç) dhe (d), nuk ka paraqitur deklaratë mbi origjinën e mallit, vendin e prodhimit dhe kompaninë prodhuese. Gjithashtu nga ky operator nuk rezulton që të jetë depozituar në SPE autorizimi nga firma prodhuese (Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit), nga prodhuesi ose distributori zyrtar i autorizuar ku të provohet lidhja mes “FILO GAS” sh.p.k dhe Mbajtësi i Autorizimit të Tregtimit, nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barin objekt prokurimi, ku ky autorizimi duhet të jete i vlefshem gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së procedurës (nga momenti i zhvillimit të procedurës deri në përfundim të kontratës me AK). Në dokumentat e paraqitura nga OE “FILO GAS” sh.p.k gjithashtu mungon edhe deklarata e kërkuar në gërmën (e) dhe (dh), të pikës 2.3 kapaciteti teknik ku OE merr përsipër që të furnizojë AK, kurdo që të jetë e nevojshme, 24/24 orë në 7 ditë të javës, si dhe se garanton AK që depozitat*****

(tankerat) që administrohen pranë AK, do të kenë gjithmonë një sasi rezerve disponibël prej minimalisht 20 % (njëzet përqind) të volumit mbajtës. Gjithashtu në lidhje me gërmën (dh) mungon dhe dokumentacioni shoqërues i cili të vërtetoj disponimin nga ky OE të bombulave të oksigjenit të gaztë sipas kritereve teknike të kërkuara në DST, apo çertifikatën nga e cila vërteton pronësinë apo disponueshmërinë e këtyre bombulave. Për këtë arsye, OE “FILO GAS” sh.p.k, nuk i përmbush kriteret e vendosura në gërmën (e) dhe (dh) të pikës 2.3 kapaciteti teknik. **dh) Operatori Ekonomik ofertues, duhet të paraqesë Autodeklarate që merr përsipër që brenda 5 (pesë) ditëve nga lidhja e kontratës, të bëjë zëvendësimin e Tankerave me Nr. Rendor 2, 3, 4, 5, 6, 7, të cilat nuk janë pronë e QSUT-së, si dhe se në rastin e nevojës së ndërrimit të Tankerave, do të bëjë më parë pajisjen me nga 6 (gjashtë) bombola oksigjeni gaz\*\*, rampat si më poshtë dhe rampat e Kardiokirurgjisë dhe Spitalit të Specialiteteve (Francez) për siguruar gatishmerinë e furnizimit me oksigjen të shërbimeve spitalore. Disponimin e tankerave, duhet ta vërtetojë nëpërmjet dokumentacionin ligjor si: faturë tatimore shitje ose formular zhdoganimit per importin e tankerave ose kontrate qiraje (Qeradhenesi duhet te paraqese faturen tatimore te blerjes ose formularin e cdoganimit) ose vertetimin nga ISHTI; Sipas gërmës (ë) të pikës 2.3 kapaciteti teknik thuhet se: ë) Operatori Ekonomik ofertues, duhet të paraqesë Autodeklarate që merr përsipër se gjatë periudhës së zëvendësimit të tankerave të oksigjenit të lëngshëm, merr përsipër mbulimin e nevojave aktuale në QSUNT me oksigjen të gaztë me anë të bombulave duke patur parasysht se konsumi aktual në QSUNT është rreth 20,000 litra oksigjen i lëngshëm në 24 orë dhe se bombulat e oksigjenit të gaztë të përdorura gjatë periudhës së zëvendësimit të tankerave të oksigjenit të lëngshëm do të jenë të regjistruara dhe çertifikuara ISHTI sipas ligjit për enët nën presion ose ekuivalente e saj. Në dokumentat e paraqitura nga OE “FILO GAS” sh.p.k, nuk u evidentua asnjë lloj dokumenti i cili vërtetonte disponueshmërinë e këtyre bombulave, dokument i regjistrimit apo i çertifikimit të këtyre bombulave nga ISHTI apo ekuivalente e saj. Kriteri i përcaktuar në këtë pikë nuk përmbushet nga OE “FILO GAS” sh.p.k. Siç është deklaruar edhe më sipër, referuar nëit 74 pika 3, Bashkimi i operatorëve ekonomikë, duhet që secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje. Sa më sipër, referuar nëit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” I Gjithashtu në nenin 53, pika 3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”. Për sa më sipër,**

nga shqyrtimi i kësaj ofertë, në mbështetje me **nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Per Prokurimin Publik”**, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit, u konstatua se oferta e **Bashkimit të Operatoreve “LG WEST BALKAN” dhe “FILO GAS” sh.p.k nuk ka të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilesuar si ofertë të pavlefshme.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

**1. “GTS” Shpk,** **NIPT: J61905015B**  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

**Vlera: 908,248,025,94** (nëntëqind e tetë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e njëzet e pesë presje nëntëdhjetë e katër) **leke pa TVSH; Çmimi për njësi: 135,21** (njëqind e tridhjetë e pesë presje njëzet e një) lekë pa TVSH;

**Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me adresë Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft-marrëveshjen.**

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **09.02.2021**

**Ankesa:** Nuk ka pasur ankesa!

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Enkelejdi JOTI**